



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 5.3.2025

- Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 524, datë 08.04.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u administruan, shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, prapësimet dhe aktet e administruara në cilësinë e provës në funksion të shkaqeve të ankimit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në referencë të përmbajtjes së akteve të administruara dhe nivelit të provueshmërisë së tyre në lidhje me shkaqet e ankimit, parashtron si vijon:

**I. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë**

1. Lidhur me shkakun e ankimit, për pasurinë “*Apartament me sipërfaqe 87,3 m<sup>2</sup> dhe verandë me sipërfaqe 73,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\* \*\*”, Tiranë*”.

1.1 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e datës 27.1.2025, në kushtet kur: (i) nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni ka rezultuar se përfundimi i arritur lidhur me këtë pasuri nuk është plotësisht i mbështetur në provat e administruara dhe ligjin e zbatueshëm, sa i përket pagesës e kryer pranë \*\*\*-së, në shumën 21.493,55 euro, dhe (ii) nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, janë paraqitur rrethana kontraktore në lidhje me elementë të rëndësishëm të marrëdhënies kontraktuale ndërmjet shoqërisë, subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, e që kanë të bëjnë me momentin e pagesës së çmimit,

si dhe subjektit që kryen pagesat, ka çmuar si të nevojshëm një hetim të mëtejshëm nga ana e Kolegjit, duke kërkuar:

1.1.1 Të administrohet informacion nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., lidhur me veprimet e kryera nga ana e saj në lidhje me apartamentin e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, si dhe të qartësojë mënyrën e pagesës, kohën e kryerjes së pagesave, shumat përkatëse dhe personat që i kanë realizuar ato.

1.1.2 Gjithashtu, pasi është konstatuar se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshorti, z. \*\*\* \*\* i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar në funksionin e prokurorit, është kërkuar administrimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të procedimit penal të datës \*\*.5.2022, për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim të dokumentit” dhe të dy akteksptimeve grafike, përkatësisht të datave \*\*.6.2022 dhe \*\*.10.2022, të cituara në paragrafin 40 të vendimit të Komisioni për subjektin \*\*\* \*\*, që kanë të bëjnë me pagesën e kryer pranë \*\*\* në shumën 21.493,55 euro.

1.2 Kolegji i Posaçëm i Apelit në seancën gjyqësore datë 27.1.2025 ka vendosur, ndër të tjera, të çelë hetimin gjyqësor të çështjes, të marrë në cilësinë e provës aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe të administrojë informacion nga shoqëria ndërtuese, për sa i përket veprimeve të kryera nga ana e shoqërisë për apartamentin e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, si dhe të qartësojë mënyrën e pagesës, kohën e kryerjes së pagesave, shumat përkatëse dhe personat që i kanë realizuar ato.

1.3 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, referuar parashtrimeve dhe akteve të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova, lidhur me pasurinë “Apartament me sipërfaqe 87,3 m<sup>2</sup> dhe verandë me sipërfaqe 73,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\* \*\*”, Tiranë” dhe çështje të lidhura me të, konstaton se:

1.4 Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e depozituara në Kolegj, ndër të tjera ka deklaruar se për blerjen e apartamentit objekt analize është paguar në total shuma 104.000 euro nëpërmjet pagesave cash të kryera nga bashkëshorti i saj në datat \*\*.07.2012 dhe \*\*.07.2012 dhe se pas kësaj date nuk është kryer asnjë pagesë tjetër. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se transaksioni i datës \*\*.12.2012 në \*\*\* nuk është kryer nga z. \*\*, por është kryer nga punonjësit e shoqërisë për të dokumentuar pagesën e çmimit të apartamentit me transaksion bankar.

1.5 Në mbështetje të pretendimeve të sipërcituara, subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj ka paraqitur aktet si vijon:

1.6 Me shkresën nr.\*\*\* prot/\*\*\*.\*\*\*., datë \*\*.1.2025, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është përcjellë një kopje e akteve të procedimit penal nr.\*\*\* të vitit 2022, nga ku rezulton se:

1.6.1 Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në datë \*\*.5.2022 ka regjistruar procedimin penal nr.\*\*\* për veprën penale “Falsifikim i dokumentit” dhe “Shpërdorim i detyrës” mbi bazën e kallëzimit penal të shtetases Elfrida Bregova. Për hetimin e kësaj çështje, organi procedues ka kryer sekuestrimin në origjinal pranë

Bankës \*\*\* \*\* të dokumentave: (1) “*Depozitim në cash nga jo titullarë*” datë \*\*.12.2012, vlera 21.493,55 euro, në bankën \*\*\* dhe (2) “*Mandat arkëtimi*” datë \*\*.12.2012, vlera 21.493,55 euro, në bankën \*\*\*. Këto dy dokumenta janë dërguar për ekspertim grafik të shkrimit në Institutin e Policisë Shkencore Tiranë dhe në vijim janë kryer dy ekspertime grafike përkatësisht akt-ekspertimi grafik nr.\*\*\*, datë \*\*.6.2022 dhe nr. \*\*, datë \*\*.10.2022.

1.6.2 Në përfundim të ekzaminimeve të mësipërme, eksperti kriminalist \*\*\* \*\*, ndër të tjera, ka arritur në konkluzionin se:

1.6.2.1 Shkrimi emër mbiemër “\*\*\* \*\*” dhe “*nënshkrimi*”, në dokumentat objekt ekspertimi “*mandat arkëtimi*” dhe “*depozitim cash nga jo titullarë*” të Bankës \*\*\* \*\* të datës \*\*.12.2012, **nuk janë shkruar dhe nënshkruar nga shtetasit \*\*\* \*\* dhe Elfrida Bregova** krahasuar me modelet e paraqitura në emër të tyre.

1.6.2.2 Shkrimi emër mbiemër “\*\*\* \*\*” dhe “*nënshkrimi*”, në dy dokumentet objekt ekspertimi janë shkruar dhe nënshkruar nga i njëjti person.

1.6.3 Në vijim, me vendimin e datës \*\*.12.2022 është marrë e pandehur shtetasja \*\*\* \*\* (punonjësja e bankës) e cila është akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Falsifikim i dokumentit*”.

1.6.4 Me shkresën nr. \*\*/\* prot., datë \*\*.1.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ka informuar se çështja me të pandehur shtetasen \*\*\* \*\* është aktualisht në gjykim.

1.7 Me anë të deklaratës noteriale nr.\*\*\* rep., dhe nr.\*\*\* kol., datë \*\*.6.2022, z.\*\*\* \*\*, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., ndër të tjera, ka deklaruar [...] vlera 97.000 euro paguar cash nga z.\*\*\* \*\* është arkëtuar nga shoqëria \*\*\* sh.p.k., sipas manadat arkëtimin nr.\*\*, datë \*\*.7.2012. Kjo shumë është depozituar në bankë pjesë-pjesë në ditë të ndryshme nga përfaqësuesit e shoqërisë \*\*\* sh.p.k., pranë dy bankave ku subjekti ka pasur llogari bankare, përkatësisht pranë bankës \*\*\* dhe \*\*\* ... Në përshkrimin e depozitimit janë vendosur të dhënat e kontratës për apartamentin e porositur nga z.\*\*\* dhe emri i z. \*\*\* është vendosur për të kryer verifikimin e klientit dhe rakordimin kontabël nga shoqëria ... Ndërmjet shoqërisë \*\*\* sh.p.k., dhe z.\*\*\* \*\* nuk ka rrethana të tjera të marrëdhënies civile lidhur me apartamentin \*\*\* [...].

1.8 Me shkresën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr.\*\*/\* prot., datë 17.1.2025, janë përcjellë akte që i përkasin dosjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.\*\*\*, datë \*\*.1.2023, për subjektin e rivlerësimit z. \*\*\* \*\*.

1.8.1 Bashkëlidhur kësaj shkrese, është administruar dhe procesverbali për mbajtjen e deklarimeve të shtetasës \*\*\* \*\* e cila ka dhënë deklarime në Komision në cilësinë e përfaqësueses së shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., ku, ndër të tjera, ka deklaruar se [...] pagesat e z. \*\*\* janë bërë cash ... përpara sesa të marri pronësinë e apartamentit sepse nuk bëhej asnjë dhënie pronësie apartamenti pa bërë pagesën ... përgjigja e parë dhe e dytë<sup>1</sup> është

<sup>1</sup> Referon përgjigjet e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., drejtuar Komisionit gjatë hetimit administrativ.

kryer nga persona që nuk ishin në dijeni të historikut sepse personat dhe arkiva e kontabilitetit mbahej nga persona në atë moment që nuk ishin më ... ka qenë një pakujdesi në kthimin e përgjigjes pasi kur ju rikthyem ishin gjithë ato dokumenta që nga arka janë kaluar në bankë ... pagesa e z. \*\*\* ... Po të kontrolloni pagesat në bankë janë në emër të z. \*\*\*, por janë bërë nga personeli i shoqërisë [...].

1.8.2 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit për të provuar se arkëtime *cash* të çmimeve të apartamenteve të blerë pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., janë kryer dhe nga shtetas të tjerë, ka paraqitur dy kontrata të kësaj shoqërie me palë të treta, përkatësisht: (i) Kontratë porosie nr.\*\*\* prot., datë \*\*.4.2011, dhe (ii) Kontratë sipërmarrje nr.\*\*\* prot., datë \*\*.10.2010.

1.8.3 Në vijim, Kolegji i Posaçëm i Apelimit me shkresën nr. \*\*/\*\* prot., datë 24.2.2025, ka përcjellë shkresën nr. \*\*/\*\* regj., datë 24.02.2025, të gjyqtarës kryesuese, bashkëlidhur së cilës, ndër të tjera, është përcjellë shkresa kthim përgjigje datë 11.2.2025 e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ku citohet se referuar kërkesës së Kolegjit për informacion për transaksionet lidhur me pasurinë nr.\*/\*\*\*\*+\*-\*\*, kjo pasuri ndodhet në objektin e parë të ndërtuar nga shoqëria në vitet 2010 dhe, për shkak të periudhës 15 vjeçare të kaluar, bën me dije që nuk disponojnë informacionin e kërkuar, për shkak të kalimit të afatit 5 vjeçar që kërkon legjislacioni për ruajtjen e dokumentacionit.

1.9 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, referuar parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj lidhur me pasurinë “*Apartament me sipërfaqe 87,3 m<sup>2</sup> dhe verandë me sipërfaqe 73,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\* \*\*”, Tiranë*”, konstaton se: (i) referuar dy ekspertimeve grafike të administruara bashkëlidhur akteve të procedimit penal nr.\*\*\* të vitit 2022, është provuar se pagesa e shumës 21.493,55 euro në datën \*\*.12.2012 në Bankën \*\*\* \*\* nuk është kryer nga subjekti i rivlerësimit apo nga personi i lidhur; (ii) Shtetasit \*\*\* \*\* dhe \*\*\* \*\*, në cilësinë e përfaqësuesve të shoqërisë kanë deklaruar se pagesat për blerjen e apartamentit objekt analize janë kryer *cash* nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z.\*\*\* \*\* sipas manadat arkëtimeve të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe se këto shuma janë depozituar në bankë pjesë-pjesë në ditë të ndryshme nga përfaqësuesit e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., pranë dy bankave ku subjekti ka pasur llogari bankare, përkatësisht pranë bankës \*\*\* dhe \*\*\*.

1.10 Sa më sipër, vlerësojmë se gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj u provua se pagesa në shumën 21,493.55 euro, nuk është kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur dhe si rezultat nuk duhet konsideruar si pagesë e kryer nga subjekti dhe/ose personi i lidhur përtej vlerës prej 104,000 euro që përfaqëson vlerën e paguar për blerjen e pasurisë “*Apartament me sipërfaqe 87,3 m<sup>2</sup> dhe verandë me sipërfaqe 73,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\* \*\*”, Tiranë*”.

## **II. Lidhur me vlerësimin e kriterit të figurës**

2. Lidhur me shkakun e ankimit, për vlerësimin e kriterit të figurës, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në parashtrimet e datës 27.1.2025, në kushtet kur raporti i DSIK (aktualisht AKSIK) me nr.\*\*\* prot., datë \*\*.11.2017, i cili ka referuar *Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit zj. Elfrida \*\*\**

*Bregova*, është përpiluar pa përgjigjen e një prej tre autoriteteve verifikuese, konkretisht Shërbimit Informativ Shtetëror, ka vlerësuar si të nevojshëm përditësimin e këtij raporti, me qëllim administrimin e informacionit nga institucioni verifikues, të dhënat e të cilit nuk janë marrë në shqyrtim gjatë hartimit të Raportit të parë.

2.1 Kolegji i Posaçëm i Apelit, në seancën gjyqësore datë 27.1.2025, ndër të tjera, ka vendosur të kërkojë nga AKSIK përditësimin e raportit të datës \*\*.11.2017, me qëllim administrimin e informacionit nga institucioni verifikues.

2.2 Në vijim, Kolegji i Posaçëm i Apelit me shkresën nr. \*\*/\*\* prot., datë 17.2.2025, ka përcjellë shkresën nr. \*\*/\*\* regj., datë 17.02.2025, të gjyqtares kryesuese, që njofton se Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka përcjellë pranë Kolegjit “*informacion dhe raport i përditësuar*” duke kërkuar paraqitjen pranë Kolegjit me qëllim aksesimin e raportit të përditësuar.

2.3 Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në datën 18.2.2025 u paraqit pranë Kolegjit dhe u njoh me informacionin e përcjellë nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

2.4 Sa më sipër, Raporti i DSIK-së “Mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Elfrida \*\*\* Bregova”, nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2017<sup>2</sup>, i cili ka konstatuar “*Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit...*”, mbetet akti i referuar, përsa përmban si konstatim.

### **III. Kërkimi përfundimtar i ankimit**

3. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në përfundim të këtyre parashtrimeve, në kushtet kur, mangësitë në hetim, të konstatuara për vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe të kriterit të figurës, janë shtruar gjatë hetimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, bazuar në dispozitën e pikës 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.524, datë 08.04.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Elfrida Bregova.

## **DREJTUESI I PROKURORISË SË POSAÇME**

**Altin DUMANI**

---

<sup>2</sup> Deklasifikuar plotësisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar (KDZH) nr. \*\*\*, datë \*\*.5.2021.